

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

ANALIZË E DETYRIMEVE TË
SHQIPËRISË NË PROCESIN E
ANËTARËSIMIT ME FOKUS LUFTËN
KUNDËR KRIMIT KIBERNETIK

Gentiana Bektashi



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

Gentiana Bektashi

VITI I PUBLIKIMIT

gusht 2024

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Harmonizimi i kornizës strategjike, legjislative dhe institucionale në luftën kundër krimit kibernetik me Acquis e Bashkimit European: Vështrim krahasues	04
• Kuadri strategjik dhe ligjor për luftën kundër krimit kibernetik	04
• Kuadri strategjik dhe ligjor për luftën kundër abuzimit seksual të fëmijëve, përfshirë atë në internet	06
• Kuadri institucional për luftën kundër krimit kibernetik dhe luftën kundër abuzimit online seksual të fëmijëve	07
Harmonizimi i mëtëjshëm i kornizës strategjike, legjislative dhe institucionale	08
Rekomandimet e Komisionit European për luftën kundër krimit kibernetik	10
Përfundime dhe Rekomandime	11
REFERENCA	12

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit[1] procesi i integritit evropian i Shqipërisë u fut në një fazë të re. Stadi i ri i marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Europian (BE) nënkuptonte një listë më të gjatë detyrimesh në Fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, si një nga fushat e rëndësishme dhe të ndjeshme jo vetëm për vendin tonë, por edhe për vetë BE-në. Kjo Marrëveshje përcakton dispozita (nene) të veçanta në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme (ÇDB)[2]. MSA -ja në kapitullin 7 fillon me prezantimin e rëndësisë së bashkëpunimit në këtë fushë, si një element i domosdoshëm për konsolidimin e shtetit të së drejtës në vendin kandidat.

Zhvillimet më të fundit ku me mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri[3] që u zhvillua më 19 korrik 2022, u shënua hapja zyrtare e negociatave të anëtarësimit me BE-në, e ktheu Shqipërinë zyrtarisht në një vend negociues. Ky status i ri e vendos në një hap më cilësor bashkëpunimin me BE-në si dhe vendin një hap më pranë anëtarësimit.

Në këtë Konferencë[4], Bashkimi Europian konfirmoi punën dhe arritjet e Shqipërisë në fushën e kriterëve politike, si reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por paralelisht përforcoi dhe detyrimin se për të arritur anëtarësimin, vendi duhet të plotësojë kriteret më të rëndësishme, ku konsolidimi i progresit në fushën e sundimit të ligjit, mbetet një nga fushat më të rëndësishme.

Mbështetur në metodologjinë e re të negociatave[5], Komisioni Europian do të vazhdojë të vlerësojë stadin e gatishmërisë së Shqipërisë për hapjen e negociatave në fusha

specifike, dhe të negociojë për gjashtë grupimet e kapitujve (të njohur si Clusters), duke nisur nga grupimi i parë “Themeloret”.

Grupimi “Themeloret” janë në qendër të negociatave të anëtarësimit, ndaj Kapitulli 24 “Liria, Drejtësia dhe Siguria”, si pjesë e këtij grupimi, cilësohet si një prej kapitujve më të rëndësishëm të acquis[6] të Bashkimit Europian kyç për hapjen e negociatave të anëtarësimit, pasi nga progresi i tij varen dhe kapitujt e tjerë.

Nga ana tjetër, politikat e BE-së synojnë të zhvillojnë më tej Bashkimin Europian si një fushë lirie, sigurie dhe drejtësie. Në këtë kuptim, çështje që lidhen me këtë fushë dhe specifikisht lufta kundër krimin kibernetik që do të jetë objekt i këtij artikulli, janë shumë të rëndësishme. Nga ana tjetër, lufta kundër krimin kibernetik është një çështje që një shtet anëtar nuk mund ta zgjidhë i vetëm, pasi përfshin shumë vende, prandaj shtetet anëtare duhet të jenë të afta për të zbatuar në mënyrë të përshtatshme kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta si dhe të kenë kapacitete administrative të mjaftueshme dhe të integruara brenda agjencive ligjzbatuese.

Nëse i referohemi raporteve më të fundit të progresit të Bashkimit Europian, vlerësohet se Shqipëria ka arritur progres në këtë fushë. Raporti i fundit të Komisionit Europian[7] për vitin 2023 për luftën kundër krimin të organizuar në tërësi vlerëson se “Vendi ka një lloj niveli përgatitjeje për zbatimin e acquis-it të BE-së në këtë fushë. Vendi ka shënuar progres në zbatimin e rekomandimeve të vitit të fundit”, [8] dhe specifikisht në luftën kundër krimin kibernetik, raporti vlerëson se “Shqipëria është palë e Konventës së Budapestit për krimin kibernetik dhe në shkurt 2023 nënshkroi Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike”.

Harmonizimi i kornizës strategjike, legjislativë dhe institucionale në luftën kundër krimit kibernetik me Acquis e Bashkimit Europian: Vështrim krahasues

Kuadri strategjik dhe ligjor për luftën kundër krimit kibernetik

Gjatë viteve të fundit, ajo që vihet re është një vëmendje e shtuar për harmonizimin e kornizës strategjike, legjislativë dhe institucionale me Acquis e Bashkimit Europian, provë e së cilës janë ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare, përafrimi i legjislacionit vendas dhe akteve nënligjorë ngritja e strukturave institucionale me qëllim afrimin me standardet e kërkuara nga Bashkimi Europian.

Kështu, legjislacioni shqiptar në fushën e luftës kundër krimit kibernetik, është në përputhje me:

- Konventën për Krimin Kibernetik e 23 nëntorit të vitit 2001[9];
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA i 28 majit të vitit 2001 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo kesh;
- Direktivën 2013/40/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 12 gusht 2013 mbi sulmet kundër sistemeve të informacionit që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/222/JHA;
- Protokollin e Konventës për krimin kibernetik të Këshillit të Europës lidhur me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

Gjithashtu Shqipëria është palë e Konventës së Budapestit për krimin kibernetik dhe së fundmi ka nënshkruar Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike [10].

Po ashtu, Shqipëria ka një kuadër të plotë strategjik në fushën e luftës kundër krimit kibernetik. Është miratuar dhe po zbatohet Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 dhe plani e saj i veprimit[11], ndërkohë që është në proces hartimi Plani i ri i Veprimit për vitet 2024-2025. Po zbatohet Strategjia për Hetimin e Krimin Kibernetik 2021-2025 dhe Plani i saj i veprimit për vitet 2021-2025.[12]

Legjislacioni shqiptar në luftën kundër krimit kibernetik, rezulton pjesësisht i përafruar me legjislacionin e BE-së dhe është i rregulluar përmes këtyre akteve kryesore shqiptare:

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr.8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”
- Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr.9887, datë 10.3.2010 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014
- Ligji nr.9262, datë 29.7.2004 “Për ratifikimin e “Protokollit shtesë të Konventës për krimin penal për penalizimin e racave dhe akteve të natyrës ksenofobe të krijuar nga sistemet kompjuterike”

- Ligji nr. 71, datë 20.10.2022 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e dytë shtesë të Konventës për krimin kibernetik për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike” etj.

Nëse do të bëjmë një analizë më të detajuar të kuadrit tonë ligjor në raport me legjislacionin eBE-së, shkalla e harmonizimit e korpunit të akteve të BE së në këtë fushë në legjislacionin shqiptar, paraqitet si më poshtë:

Vendimi Kuadër i Këshillit 2001/413/JHA i datës 28 maj 2001 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo kesh, është përafuar plotësisht në “Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar[13]

Direktiva (BE) 2019/713 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 17 Prill 2019 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo kesh[14] që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë është plotësisht i harmonizuar me Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA të 28 majit 2001 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo kesh. Duke qenë se ky Vendim është zëvendësuar nga Direktiva (BE) 2019/713 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 17 Prill 2019 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo kesh, janë të nevojshme ndryshimet ligjore në Kodin Penal shqiptar[15].

Direktiva 2013/40/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 12 gusht 2013 mbi sulmet kundër sistemeve të informacionit dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/222/JHA është përafuar plotësisht me aktet:

- “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, [16] i ndryshuar
- Ligji Nr.2/2017 Për sigurinë kibernetike
- VKM Nr.222 datë 26.04.2017 “Për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe atyre të rëndësisë së veçantë“, si dhe në dokumentet strategjike :
- Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike 2018-2020
- Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 dhe Plani i Veprimit 2020-2025
- Strategjia e Hetimit të Krimit Kibernetik 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2025

Propozimi për një Rregullore të Parlamentit Europian dhe të Këshillit për prodhimin dhe ruajtjen e provave elektronike në çështjet penale është transpozuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012; nr. 107/2018, datë 20.12.2018; nr. 92/2019, datë 18.12.2019) [17], i ndryshuar

Konventa e Këshillit të Europës për krimin kibernetik, 23 nëntor 2001 është përafuar plotësisht me:

- Ligjin nr.8888, datë 25.4.2002, për ratifikimin e “Konventës për krimin kibernetik”.
- “Kodin e Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, [18] i ndryshuar
- “Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”[19], i ndryshuar
- Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimin elektronik”, i ndryshuar, i cili rregullon ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale.

- Ligjin nr.9887, datë 10.3.2010, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014.

Protokollin e Konventës për krimin kibernetik të Këshillit të Europës, lidhur me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike, nënshkruar më 28 janar 2003, është përafuar plotësisht me:

- “Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”[20], i ndryshuar
- Ligjin nr.9262, datë 29.07.2004 “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik, për kriminalizimin e akteve raciste dhe natyrë ksenofobike që kryhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike”

Rregullorja (BE) 2021/1232 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 14 korrik 2021 mbi një shmangie të përkohshme nga disa dispozita të Direktivës 2002/58/KE në lidhje me përdorimin e teknologjive nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri për përpunimin e të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera me qëllim të luftimit të abuzimit seksual të fëmijëve në internet, është pjesërisht e përafuar me Ligjin nr.9918/2008 “Për komunikimet elektronike”.

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual - është përafuar plotësisht me:

- Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Ligjin nr.10071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit Europian (Lanzarote)[21] “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”.

Kuadri strategjik dhe ligjor për luftën kundër abuzimit seksual të fëmijëve, përfshirë atë në internet

Shqipëria është pjesërisht e përputhur me kuadrin ligjor të BE-së edhe në lidhje me luftën mbi abuzimin seksual të fëmijëve, përfshirë atë në internet. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual. me ligjin nr.10071, datë 9.02.2009. Kuadri ligjor është pjesërisht i përafuar me *acquis* e BE-së. Ai përputhet plotësisht me Vendimin e Këshillit 2000/375/JHA për të luftuar pornografinë e fëmijëve në internet. Ai përafrohet pjesërisht me Direktivën 2011/93/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 dhjetor 2011 për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve. Po ashtu, përafrohet pjesërisht dhe me Rregulloren e (BE) 2021/1232 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 14 korrik 2021 mbi një shmangie të përkohshme nga disa dispozita të Direktivës 2002/58/KE në lidhje me përdorimin e teknologjive nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri për përpunimin e të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera me qëllim të luftimit të abuzimit seksual të fëmijëve në internet[22].

Legjislacioni ynë në këtë fushë është pjesërisht i përafuar përmes :

- Kodin Penal, i ndryshuar
- Kodin të Drejtësisë Penale për të Mitur (ligji nr. 37/2017);
- Kodin të Procedurës Penale, i ndryshuar
- Ligjin nr.18/2017 për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

- Ligjit nr.9918/2008 “Për komunikimet elektronike”
- Ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pasurisë”, i ndryshuar.

Nëse do të bëjmë një analizë më të detajuar të kuadrit tonë ligjor në raport me legjislacionin e BE-së, shkalla e harmonizimit e korpusit të akteve të BE së në këtë fushë në legjislacionin shqiptar, paraqitet si më poshtë:

Vendimi i Këshillit 2000/375/JHA për të luftuar pornografinë e fëmijëve në internet, qershor 2000, është përshtatur plotësisht [23] me:

- Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Ligjin nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike”

Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA, datë 17.12.2011, [24] është pjesërisht e përafuar përmes:

- Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (ligji nr. 37/2017)
- Ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pasurisë”, i ndryshuar.

Rregullorja (BE) 2021/1232 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 14 korrik 2021 mbi një shmangie të përkohshme nga disa dispozita të Direktivës 2002/58/KE në lidhje me përdorimin e teknologjive nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri për përpunimin e të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera me qëllim të luftimit të abuzimit seksual të fëmijëve në internet është pjesërisht e përafuar me:

- Ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike” [25]

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual është i përafuar plotësisht me:

- Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Ligjin nr.10071, datë 9.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit Europian (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”.

Kuadri institucional për luftën kundër krimit kibernetik dhe luftën kundër abuzimit online seksual të fëmijëve

Zhvillime pozitive ka pasur dhe përsa i takon rritjes dhe forcimit të strukturave institucionale që merren me luftën kundër krimit kibernetik. Një nga zhvillimet e fundit, lidhet me ndryshimet në Policinë e Shtetit në vitin 2023, ku në nivel qendror është ngritur Drejtoria e Hetimit të Krimeve Kibernetike, e cila përbëhet nga 3 Sektorë: atë për Hetimin e Mashtrimeve Kompjuterike, për Hetimin e Falsifikimeve dhe Ndërhyrjeve Kompjuterike, për Hetimin e Pornografisë së Fëmijëve dhe një njësi të koordinimit 24/7.

Ky riorganizim është bërë dhe në nivel vendor, kupranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe në 11 Drejtoritë vendore të Policisë së Shqipërisë, strukturat për krimin kibernetik janë organizuar në një sektor/seksion të veçantë për Hetimin e Krimeve Kibernetike.

Përpjekje janë bërë dhe për të forcuar kapacitetet institucionale në fushën për mbrojtjen e të miturve nga pornografia online. Ndër iniciativat më të fundit është ngritja në Drejtorinë për Hetimin e Krimin Kibernetik (Policinë e Shtetit) e Sektorit për Hetimin e Pornografisë për të Mitur për të hetuar rastet e veprave penale të kryera përmes përdorimit të teknologjisë ku të miturit përfshihen si viktima, apo dhe ato të pornografisë me të mitur etj. Këto struktura tashmë funksionojnë edhe në strukturat vendore të policisë. Pjesë e detyrave të specialistit të kësaj fushe, është parashikuar dhe edukimi në shkolla dhe puna me të rinjtë.

Harmonizimi i mëtejshëm i kornizës strategjike, legjislativë dhe institucionale

Deri në momentin e anëtarësimit të plotë, Republika e Shqipërisë do të duhet të ndër marrë hapa legjislativë për të garantuar harmonizimin me *acquis* e BE-së në fushat në të cilat ajo aktualisht nuk është e harmonizuar. Krahas aktiviteteve legjislativë, duhet të merren masa për të garantuar një nivel të përshtatshëm gatishmërie institucionale dhe administrative për të plotësuar të gjitha detyrimet që hyjnë në fuqi në momentin e anëtarësimit të plotë në Bashkimin Europian.

Rekomandimet e Komisionit Europian të shprehura përmes progres raporteve, takimeve dypalëshe BE-Shqipëri si: KSA[26], JFS[27], takimet bilaterale në kuadër të procesit screening etj. përbejnë bazën e detyrimeve që duhen përmbushur në këtë proces.

Njëkohësisht, përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, është një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij është vetë procesi i negociatave të anëtarësimit.

Puna e realizuar nga Grupet Ndërinstitucionale të Punës në kuadër të vlerësimit analitik të legjislacionit shqiptar për përgatitjen e takimeve bilaterale[28], shërbeu si një ushtrim i mirë për nivelin e përgjithshëm të përafrimit të legjislacionit si dhe për të vlerësuar kapacitetet administrative në këtë fushë. Nga ana tjetër, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës[29], i cili përcakton hapat konkrete që do të merren nga viti 2024 deri 2030, është një bazë e mirë për Kapitullin 24 për realizimin e detyrimeve të anëtarësimit duke përfshirë dhe prioritetet dhe masa në kuadër të luftës kundër krimin kibernetik. Po ti referohemi këtij udhërrëfyesi aty janë vendosur një sërë masash duke përcaktuar dhe afatet përkatëse si për përmirësimin e kuadrit ligjor ashtu dhe për përforcimin e kuadrit institucionale dhe kapaciteteve zbatuese, si për luftën kundër krimin kibernetik dhe mbrojtjen e të miturve nga pornografia online.

Prioritetet e vendosura në këtë Udhërrëfyes për luftën kundër krimit kibernetik janë:

- Zbatimi i qëndrueshëm i Strategjisë Kombëtare ekzistuese të Hetimit të Krimit Kibernetik në Shqipëri 2021- 2025 dhe Planit të Veprimit Shtesë deri në vitin 2025, duke përfshirë rinovimin dhe ndjekjen e tyre për periudhën 2026-2030.
- Sigurimi i ndryshimeve të mëtejshme të legjislacionit kombëtar, duke përfshirë përafrimin e tij me Direktivën (BE) 2019/713 dhe Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike, (2025)
- Sigurimi i hetimit sistematik të krimeve kompjuterike nga dhe nën drejtimin e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike në Policinë e Shtetit.
- Pajisja e Policisë së Shtetit me kapacitete laboratorike të kriminalistikës së krimit kibernetik, si në nivel qendror ashtu edhe në terren. (2024)
- Ofrimi i trajnimeve dhe aktiviteteve sensibilizuese për prokurorët për të përmirësuar përdorimin e rrjetit të pikave të kontaktit 24/7 të krijuar nga Konventa e Këshillit të Europës për Krimin Kibernetik (në vazhdimësi).

Mbi parandalimin dhe luftën e abuzimit seksual të fëmijëve online janë vendosur dy qëllime madhore në këtë udhërrëfyes: Si fillim, legjislacioni duhet të jetë i përafruar dhe të zbatohet në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur (përfshirë pajisjet dhe personelin e specializuar) dhe gjithashtu të ekzistojnë masat për zbulimin, mbrojtjen dhe kujdesin ndaj viktimave dhe ato të zbatohen në mënyrë efektive.

Masat e parashikuara më konkretisht janë:

- Miratimi i ndryshimeve ligjore përkatëse në mënyrë që të kriminalizohen të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet dhe sigurimi i përafrimit të Ligjit 10192/2009 me Direktivën e BE-së 2011/93.
- Rritja e kapaciteteve teknike për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ndaj fëmijëve të kryera përmes internetit.
- Rritja e numrit të reaguesve të parë të PSH-së të trajnuar ndaj abuzimit të fëmijëve në nivel Qarku.

Një nga mekanizmat e brendshëm për të avancuar në këtë drejtim, është hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar për Integrimin European[30] që ka për qëllim të koordinojë këtë proces përafrimi duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe detyrimet që lindin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin European. I planifikuar në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, si një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të të gjitha reformave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA, hartimi me cilësi dhe monitorimi i tij janë parakusht për përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit European. Në këtë dokument përveç analizës së situatës aktuale që i bëhet çdo kapitulli të Acquis së BE, si kuadri ligjor dhe strategjik, ashtu dhe kuadri institucionale dhe kapacitete zbatuese të legjislacionit vendosen dhe masat prioritare për çdo kapitull, bazuar dhe në rekomandimet e ardhura nga Komisioni European nëpërmjet raporteve të progresit dhe takimeve dypalëshe.

Rekomandimet e Komisionit European për luftën kundër krimit kibernetik

Rekomandimet e Komisionit European[31] për fushën e krimit kibernetik lidhen me miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik [32] në këtë fushë, përmirësimin e track-record-it për të krijuar një reagim më efektiv të zbatimit të ligjit, për zbulimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen penale të krimeve kibernetike, forcimin e kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kundër fëmijëve të kryera përmes internetit etj.

Nëse i referohemi progres raportit të fundit të Komisionit European për vitin 2023, ai evidenton se “Ndryshimet legjislative për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet ende nuk janë miratuar” Gjithashtu progres raporti [33]rekomandon që “Shqipëria duhet të ofrojë një përgjigje më efektive të zbatimit të ligjit që fokusohet në zbulimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen penale të kriminelëve kibernetikë. Shqipëria duhet të inkurajojë prokurorët që të përdorin më shumë rrjetin 24/7 të pikave të kontaktit të krijuar nga Konventa e Këshillit të Europës për krimin kibernetik. Njësia e Krimeve Kibernetike të PSH-së ka një laborator qendror të mjekësisë ligjore, por duhet të rrisë kapacitetin e saj për t'u marrë me raste të tilla. Duhet të forcohen kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ndaj fëmijëve të kryera përmes internetit.”

Situata aktuale në botë lidhur me krimin kibernetik, po dhe fakti që gjatë vitit 2022, Shqipëria ishte viktimë e një sulmi kibernetik i cili çoi në ndërprerjen e përkohshme të shumicës së shërbimeve publike online, tregojnë se lufta kundër krimit kibernetik, mbetet një fushë sfiduese në të cilën nevojiten përpjekje të mëtejshme.

Megjithëse gjatë këtyre viteve Shqipëria ka përmirësuar dukshëm kuadrin e saj ligjor dhe institucional të brendshëm në fushën e luftës kundër krimit kibernetik, deri në anëtarësimin e saj të plotë do të duhet të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të garantuar harmonizimin me *acquis* të BE-së në fusha në të cilat ajo aktualisht nuk është e harmonizuar.

Mangësitë legjislative apo institucionale, lidhen kryesisht me mungesën e akteve ligjore dhe nënligjore, mungesën e dispozitave ligjore sa i përket Kodit Penal, po dhe me fuqizimin e strukturave përkatëse^[1] në këtë fushë. Kjo nënkupton që rruga për të plotësuar detyrimet e anëtarësimin nuk është e lehtë dhe shkon përtej miratimit të akteve ligjore. Krijimi apo fuqizimi i strukturave të reja, do të duhet të mbështetet dhe me burimeve të përshtatshme buxhetore dhe njerëzore, që nënkupton një kosto ekonomike dhe financiare që duhet të llogaritet dhe të pranohet.

Po ashtu, procesi mbetet kompleks, pasi përfshin shumë institucione dhe agjenci publike në nivel kombëtar dhe lokal, që në aspektin institucional, do të kërkojnë koordinim dhe forcim të aftësive përthithëse të kapaciteteve njerëzore që nënkupton mbështetjen e stafit, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe si ofrimin e asistencës specifike. Nga ana tjetër ky proces kërkon dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të shoqërisë civile dhe botës akademike për të ofruar dhe për të ndarë ekspertizën më të mirë mes aktorëve (shtetërorë dhe joshetërorë) për plotësimin e standardeve në këtë fushë specifike, po dhe në tërësi për plotësimin e detyrimeve të anëtarësimin.

[1] Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit European dhe Shqipërisë u nënshkrua më 12 qershor 2006

[2] Drejtësia dhe Cështjet e Brendshme

[3]https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/first-intergovernmental-conferences-albania-and-north-macedonia-kick-start-accession-negotiation-2022-07-19_en

[4] Më 19 korrik 2022 në Bruksel, u mbajt Konferenca e Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe BE-së. Shqipëria nisi bisedimet zyrtare në tryezë me Bashkimin European.

[5]https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enhancing-accession-process-credible-eu-perspective-eastern-balkans_en

[6] Korpusi i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta të BE-së i inkorporuar në sistemet ligjore të shteteve anëtare të BE-së.

[7] Komisioni European çdo vit publikon Progres Raportet kuvlerëson progresin e vendit aspirant për anëtarësim, sa i përket reformave të ndërmarra. Raporti bën një vlerësim cilësor nëse është arritur progres ose jo, apo nëse progresi i arritur është i rëndësishëm apo i limituar duke iu referuar shprehjeve të veçanta cilësore që raportet përdorin për të përshkruar progresin në lidhje me përmbushjen e kërkesave të BE-së. Fjala "progres" është shprehja kyesore e raportit.

[8] Rapori i Komisionit për vitin 2023, fq. 41 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

[9] <https://www.europarl.europa.eu/cmsdata/179163/20090225ATT50418EN.pdf>

[10] Në datë 27 shkurt 2023, Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, z. Dastid Koreshi, firmosi në praninë e zv. Sekretarit të Përgjithshëm të KiE, z. Bjørn Berge, Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik (CETS224).

[11] Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 dhe plani i saj i veprimit është miratuar me VKM nr.1034 datë 24.12.2020

[12] Strategjia e Hetimit të Krimin Kibernetik 2021-2025, si dhe Plani i Veprimit 2021-2025 është një dokument strategjik sektorial.

[13] Kodi penal është përafuar plotësisht me Vendimim Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA - Neni 143/b dhe 184 parashikojnë si vepër penale mashtrimin kompjuterik dhe falsifikimin e mjeteve të pagesës jo kesh.

[14] Duhet të përafrohet Direktiva 2019/713 që zëvendëson Vendimim Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA.

[15] Ndryshimi i Kodit Penal është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin European 2024-2026 nga Ministria e Drejtësisë.

[16] Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënave kompjuterike
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike
Neni 23 Përgjegjësia për tentativën
Neni 27 Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve
Neni 45 Zbatimi i Ligjit penal ndaj personeve juridikë
Neni 7 Zbatimi i Ligjit Penal për veprat Penale të kryera nga shtetas të huaj

[17] Në nenin 101 të Ligjit, është rregulluar ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale

[18] Neni 191/a Detyrimi për paraqitjen e të dhënave kompjuterike
Neni 208/a Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike
Neni 299/a Ruajtja e përshpejtuar e të dhënave kompjuterike.
Neni 299/b Ruajtja e përshpejtuar dhe zbulimi i pjesshëm i të dhënave kompjuterike

[19] Neni 74/a, 84/a, 119/a dhe b
143/b, 186/a, 192/b, 293/a, b, c, ç

[20] Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve në favor të gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit
Neni 84/a Kërcënimi për motive raciste dhe ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik

[20] Neni 119/a Përhapja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik
Neni 119/b Fyerja për motive raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik

[21] Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, është miratuar në Tetor të vitit 2007 në Lanzarote, Spanjë dhe ka hyrë në fuqi në datën 1 Korrik 2010.

[22] Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin lidhur me përgjegjësinë e personave juridikë.

[23] Neni 117 “Pornografia” (Kodi Penal)
Neni 27 “Mbrojtja e fëmijës nga aksesi në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet” (Ligji nr.18/2017)

[24] Lidhur me këtë direktivë ka mangësi në legjislacionin shqiptar, referuar neneve 21-25 të kësaj direktive.

[25] Neni 15/e Respektimi i kufizimeve në lidhje me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve ligjore përkatëse në fuqi.

[26] Komiteti i Stabilizimit Asociimit

[27] Takimi i 15-të i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë u zhvillua më 20-21 mars 2024

[28] Takimi bilateral BE -Shqipëri për kapitullin 24, zhvilluar në nëntor të vitit 2022

[29] Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 736 datë 13.12.2023

[30] Plani Kombëtar për Integrimin Europian hartohet për një periudhë trevjeçare

[31] Rekomandimet I referohen progres raportit të KE i vitit 2023 për Shqipërinë, Takimit të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria, Siguria”, Takimit të Komitetit të Stabilizimit- Asociimit

[32] Në bazë të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2020-2025, mbeten për t'u miratuar akte të reja ligjore dhe nënligjore për krimin kibernetik.

[33] Raporti i Komisionit Europian për vitin 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

[34] [Referuar më lart, shih Rekomandimet e Komisionit Europian për luftën kundër krimit kibernetik dhe terrorizmit, për vitin 2023](#)